



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 597 Prot.

Tiranë, më datë 03.06.2022

VENDIM

Nr. 223, datë 03.06.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 03.06.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin i rezultateve të gërmimit arkeologjik të shpëtimit realizuar nga individ i licencuar në arkeologji, znj. Iris Pojani, në kuadër të projektit “Riparimin dhe përforcimin e shkollës 9-vjecare Eftali Koci” me aplikues dhe zhvillues “Arkimade sh.p.k”;
2. Të ruhen, konservohen dhe muzealizohen rrënojat e murit dhe kullës antike në gjithë gjatësinë e tyre si dhe ndërhyrjet e vona të periudhës romake in-situ;
3. Të merren masa për konservimin arkeologjik të gjetjeve të zbuluara, regjistrimin e tyre pranë IKRTK dhe të merret në konsideratë mundësia e ekspozimit didaktik të disa prej objekteve më përfaqësuese brënda ambieteve të shkollës;
4. Të spostohet gjurma e shkollës “Eftali Koci” në pjesën e lirë të sheshit të ndërtimit duke monitoruar punimet e zbatimit në vijim të akt-marrëveshjes së lidhur më parë për këtë projekt.;
5. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

